



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

R A P O R T

PËR VETEVALUIMIN E FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË ZBATUARA

Tetovë, 11. 02. 2021

PËRMBAJTJA

1. QËLLIMI I PROCESIT TË VETEVUALIMIT	3
2. PËRSHKRIMI I FAKULTETIT	4
2.1. Historiku	4
2.2. Misioni	5
2.3. Strategjia e zhvillimit	5
3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT	7
3.1. Organogrami	7
3.2. Programet studimore	7
3.3. Vlerësimi i programit studimor aktual në nivel të programeve studimore	8
4. VEPRIMTARIA MËSIMORE	10
4.1. Bashkëpunimi me kompanitë/institucionet në nivel të programeve studimore	11
5. STRUKTURA E KUADRIT MËSIMOR-SHKENCOR.....	12
6. STRUKTURA E STUDENTËVE	19
6.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike	19
6.2. Struktura e studentëve në studimet master.....	23
7. ANKETIMI I STUDENTËVE.....	24
7.1. Anketim i studentëve për realizimin e orës mësimore në kuadër të programeve studimore.....	24
8. VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE PJESËMARRJA NË PROJEKTE	27
9. HAPËSIRAT DHE RESURSET MATERIALE	28
10. SWOT ANALIZA	32
11. KONKLUDIMI.....	35

1. QËLLIMI I PROCESIT TË VETEVUALIMIT

Qëllimi kryesor i këtij raporti është që të bëhet evaluimi i procesit mësimor në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19. Qëllimi i vetevaluimit ishte që të shohim se si ka rrjedhur dhe si është zhvilluar procesi mësimor në këto vite akademike dhe në përgjithësi si është zhvilluar FSHZ. Përfundimet që do të dalin nga ky raport i evaluimit do të shërbejnë si bazë për zhvillimin dhe ngritjen e mëtutjeshme të kualitetit të procesit mësimor –shkencor.

Evaluimi është realizuar nga komisioni i brendshëm për vetevaluim i caktuar nga Këshilli i FSHZ-së në mbledhjen e mbajtur më 16.1.2020 dhe Vendimi për formimin e anëtarëve të Komisionit me Nr. 17-774/6, më datë; 11.12. 2020, Tetovë.

Në procesin e evaluimit u përfshinë këto komponentë:

- Vlerësimi i programeve studimore, ku përfshihet themelimi, përshkrimi dhe zhvillimi i programeve studimore;
- Struktura e kuadrit mësimor;
- Struktura e studentëve në studimet deridiplomike dhe master;
- Mënyra e realizimit të procesit mësimor;
- Struktura e kuadrit udhëheqës, administrativ dhe teknik;
- Anketimi i studentëve;
- Veprimtaria shkencore dhe pjesëmarrja në projekte;
- Hapësirat dhe mjetet për realizimin e procesit mësimor.

Gjatë realizimit të procesit të evaluimit për përgatitje të këtij raporti, përveç anëtarëve të këtij komisioni, kanë kontribuar edhe profesorë, studentë si dhe administrata për marrjen dhe shfrytëzimin e të dhënave të nevojshme.

2. PËRSHKRIMI I FAKULTETIT

2.1. Historiku

Fakulteti i Shkencave të Zbatuara funksionon në kuadër të Universitetit të Tetovës. Me aprovimin e Ligjit për Themelimin të Universitetit Shtetëror të Tetovës, në vitin 2004, në kuadër të Universitetit Shtetëror të Tetovës me mësim në gjuhën shqipe u formuan pesë fakultete, mes të cilëve edhe Qendra për Studime Politeknike me dy programe studimore: 1. Ndërtimtari dhe 2. Bioteknologji, me studime trevjeçare apo gjashtë semestra.

Në vitin 2008, aprovohet ligji i ri për Universitetin Shtetëror të Tetovës, me të cilin u ndryshua dhe u plotësua ligji i vitit 2004. Me këto ndryshime, Qendra për Studime Politeknike u transformua në fakultete të veçanta: Fakultet i Shkencave të Zbatuara dhe Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore, në kuadër të Universiteti Shtetëror të Tetovës. Në kuadër të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara, përveç programit studimor të Ndërtimtarisë, i cili u transferuar nga QSP, u hapën edhe tre programe të reja studimore si: Arkitektura, Mekatronika dhe Inxhinieria Ekonomike. Dy programet studimore, Mekatronika, i cili ka funksionuar në kuadër të FSHMN-së dhe Inxhinieria Ekonomike, i cili ka funksionuar në kuadër të Fakultetit Ekonomik, kishin filluar vitin e parë akademik në vitin 2006/07.

Në programet studimore të reja, të akredituara në vitin 2007 studimet akademike zgjatnin 7 semestra me 210 kredi. Në tre programe studimore, Ndërtimtari, Mekatronikë dhe Inxhinieri Ekonomike një semestër i tërë që përfshinte 30 ECTS realizohej praktikë, kurse në programin studimor të Arkitekturës realizohej praktikë 8 javore. Këto studime sipas akreditimit të parë zgjatën deri në vitin 2012/2013.

Në vitin 2013 për nevojat e realizimit të praktikës së studentëve të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara, u themelua edhe Laboratori për testimin dhe kontrollimin e materialeve ndërtimore.

Nga viti 2013/2014 studimet në programet studimore filluan sipas akreditimit të ri dhe sipas procesit të Bolonjës. Sipas këtij akreditimi/ riakreditimi, studimet në programin studimor të Arkitekturës zgjasin katër vjet, tetë semestra me 240 ECTS, kurse në programet

studimore Ndërtimtari, Mekatronikë dhe Inxhinieri Ekonomike zgjasin tre vjet ose gjashtë semestra me 180 ECTS.

Nga viti, 2015/16 në kuadër të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara fillojnë me punë edhe dy programe studimore të reja të akredituara, edhe atë: Programi studimor Inxhinieria e Komunikacionit – Transportit me katër vjet, tetë semestra dhe 240 ECTS dhe programi studimor Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë me tre vjet, gjashtë semestra dhe 180 ECTS. Në programin studimor Inxhinieri Ekonomike nga viti 2013/2014 me akreditimin e ri e deri në vitin akademik 2020/2021, nuk ka pasur të regjistruar studentë në asnjë vit edhe pse konkursi gjithmonë, në çdo vit ka qenë i hapur.

2.2. Misioni

Misionit i Fakultetit të Shkencave të Zbatuara është nxjerrja e kuadrove profesionale dhe kualitative në drejtimet inxhinierike për plotësimin e nevojave shoqërore. Po ashtu, krijimi i kuadrit profesional akademik shkencor për nevojat e fakultetit, të cilët do të jenë në gjendje ta zhvillojnë procesin mësimor dhe t'u përgjigjen sfidave të kohës.

2.3. Strategjia e zhvillimit

Duke u bazuar në misionin e fakultetit, kryesisht nevojave të tij dhe të shoqërisë në vendin tonë, Fakulteti i Shkencave të Zbatuara në strategjinë e vetë zhvillimore, ka vendosur qëllimet dhe objektivat e veta. Në këtë drejtim, fakulteti është duke punuar vazhdimisht në funksionimin dhe realizimin e procesit mësimor në drejtimet ekzistuese duke plotësuar kushtet e nevojshme për realizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor sipas procesit të Bolonjës duke ofruar sistemin e transferit të kredive dhe në këtë mënyrë duke bashkëpunuar dhe duke u mundësuar studentëve bartjen e kredive të tyre në universitete tjera dhe nga universitetet tjera. Në kuadër të programit Erasmus plus, nga Fakulteti i Shkencave të Zbatuara, në programet e ndryshme studimore ka pasur një numër të konsiderueshëm të studentëve, të cilët përmes këtij programi bashkëpunimi dhe transferi të kredive kanë ndjekur semestrin mësimor në universitete të ndryshme.

Për realizimin me sukses të procesit mësimor në vazhdimësi tentohet të sigurohet kadri profesional adekuat, fillimisht profesorë në lëmi të ndryshme për mbulimin e të gjitha

lëndëve, por edhe duke përzgjedhur asistentët më të mirë nga radhët e studentëve dhe më gjerë, duke i inkuadruar ata fillimisht në procesin mësimor si praktikantë, demonstratorë dhe më tej në asistentë. Fakulteti është në bashkëpunim me shumë fakultetet tjera në vend dhe vendet fqinjë me ç'rast për nevoja të ndryshme ekziston edhe bashkëpunimi i kuadrit mësimor.

Përveç laboratorit për kontrollin dhe testimin e materialeve, i cili është një ndër laboratorët me pajisje më të mira në vend, në vazhdimësi përmirësohen edhe kabinetet për zhvillimin e ligjëratave dhe ushtrimeve të ndryshme me programe softuerike që zhvillohen në drejtime të ndryshme.

Objektivat dhe qëllimet afatgjate të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara janë përcjellja e zhvillimeve shoqërore si dhe atyre në fushën e industrisë duke krijuar kuadro profesionale për nevojat e shoqërisë dhe industrisë. Kjo nënkupton që varësisht nevojave së industrisë dhe shoqërisë të mund të hapen edhe drejtime të reja. Prandaj, për realizimin dhe arritjen e këtyre objektivave, fakulteti, përveç procesit mësimor në ciklin e parë, organizon edhe procesin e studimeve akademike në ciklin e dytë. Në të ardhmen, si objektivi mbetet organizimi i ciklit të tretë respektivisht studimeve të doktoraturës.

Që t'ju bëjë ballë zhvillimeve teknike-industriale si dhe nevojave të shoqërisë, fakulteti në bashkëpunim me organet më të larta të Universitetit është duke e ndjekur trendin e zhvillimeve industriale si dhe nevojat dhe kërkesat e kompanive dhe kapaciteteve industriale në vend. Për këtë arsye ekziston një bashkëpunim me këto kapacitete prodhuese industriale me qëllim edhe të marrjes së informatave për nevojat dhe kërkesat e tyre, në mënyrë që në programet përkatëse studimore përmes lëndëve të ndryshme studimore të mundësohet përgatitja dhe aftësimi i studentëve, të cilët do të mund të jenë të aftë të inkuadrohen në këto kompani apo organe të ndryshme shtetërore. Për realizimin e këtyre synimeve në të ardhmen sigurisht që kërkohet një përkrahje edhe më e madhe si nga aspekti material ashtu edhe nga ai kadrovik.

3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT

3.1. Organogrami

Në organogramin më poshtë është paraqitur mënyra e organizimit dhe funksionimit të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara, bazuar në ligjin për arsim të lartë të RMV-së.




Figura 1. Organogrami i Fakultetit

3.2. Programet studimore

Në kuadër të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara gjatë periudhës trevjeçare gjegjësisht në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19, gjatë periudhës në të cilën është realizuar procesi i evaluimit kanë funksionuar këto programe studimore:

1. Programi studimor Arkitekturë

2. Programi studimor Ndërtimtari
3. Programi studimor Mekatronikë
4. Programi studimor Inxhinieri Komunikacioni- Transporti
5. Programi studimor Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë

Programi studimor Inxhinieri Ekonomike edhe pse ishte i riakredituar nuk ka funksionuar, pra gjatë gjithë këtyre viteve ka qenë në pauzë.

3.3. Vlerësimi i programeve studimore

Programi studimor Arkitekturë

- Në kuadër të programit studimor Arkitekturë, pjesa dërmuese e lëndëve janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas kualifikimit ndërkombëtar të Fraskatit. Nga numri i përgjithshëm i lëndëve obligative, pesë lëndë janë pjesërisht në përputhshmëri sipas këtij klasifikimi.¹
- Kompetencat e definuara në deskriptorët e përgjithshëm të programit studimor, studentët i përfitojnë përmes lëndëve, gjegjësisht definimit të qëllimit të lëndës në sylabus. Te të gjitha lëndët (obligative dhe zgjedhore), kompetencat e parapara nga lëndët janë në përputhshmëri të pjesshme me deskriptorët për zhvillimin e kompetencave të programit studimor, respektivisht orientimi është në arritjen e studentëve vetëm në nivel të njohjes me dukuritë që i ofrojnë lëndët e këtij programi studimor.
- Vendosja kronologjike e lëndëve të programit studimor Arkitekturë plotësisht është në kontinuitet të zhvillimit dhe mbindërtimit të njohurive dhe shkathtësive të studentëve. Përrjashtim bëjnë të gjitha lëndët opcionale që pjesërisht janë të vendosura në të njëjtin semestër ose i paraprijnë lëndëve, njohuritë e të cilave duhet t'i mbindërtojnë.
- Lëndët të cilat e përbëjnë programin studimor Arkitekturë përgjithësisht nxisin zhvillimin e shkathtësive të cilat janë të aplikueshme në tregun e punës. Megjithatë, me qëllim të avancimit të kompetencave por edhe rritjes së efikasitetit të kuadrove të reja në fushën e arkitekturës rreth 74% e lëndëve zgjedhore(23 lëndë) si dhe 16% e

¹Lëndët janë të identifikuara nga komisioni për evaluim i fakultetit

lëndëve obligative (6 lëndë) kanë nevojë për azhurnim pasi që nxisin pjesërisht shkathtësi të cilat janë të aplikueshme në tregun e punës sipas kërkesave bashkëkohore.

Programi studimor Mekatronikë

- Në kuadër të programit studimor Mekatronikë, rreth 96% janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas kualifikimit ndërkombëtar të Fraskatit kurse një lëndë është pjesërisht në përputhshmëri sipas këtij klasifikimi.
- Kompetencat e definuara në deskriptorët e përgjithshëm të programit studimor, studentët i përfitojnë nëpërmjet lëndëve, gjegjësisht definimit të qëllimit të lëndës në sylabus. Një pjesë e caktuar e lëndëve nuk kanë aspak të shënuar zhvillimin e kompetencave por kanë të vendosura disa tema trajtimi. Te të gjitha lëndët tjera, (obligative dhe zgjedhore), kompetencat e parapara nga lëndët janë në përputhshmëri të pjesshme me deskriptorët për zhvillimin e kompetencave të programit studimor, respektivisht orientimi është në arritjen e studentëve vetëm në nivelin e njohjes me dukuritë që i ofrojnë lëndët e këtij programi studimor.
- Vendosja kronologjike e lëndëve të programit studimor Mekatronikë relativisht është në kontinuitet të zhvillimit dhe mbindërtimit të njohurive dhe shkathtësive të studentëve. Në përjashtim të një lënde obligative, lëndët tjera pjesërisht janë të vendosura në të njëjtin semestër ose i paraprijnë lëndëve njohuritë e të cilave duhet t'i mbindërtojnë.
- Duke marrë parasysh zhvillimet e fundit shkencore dhe përmbajtjen si dhe literaturën e ofruar, rreth 68% e lëndëve obligative dhe zgjedhore kanë nevojë që gjatë akreditimit të ardhshëm të azhurnohen me qëllim të plotësisht të kërkesave bashkëkohore konform arritjeve në fushën e mekatronikës.

Programi studimor Ndërtimtari

- Në kuadër të programit studimor Ndërtimtari, 91% e lëndëve janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas kualifikimit ndërkombëtar të

Fraskatit. Prej numrit të përgjithshëm të lëndëve obligative, dy lëndë janë pjesërisht në përputhshmëri me këtë klasifikim.

- Te të gjitha lëndët (obligative dhe zgjedhore), kompetencat e parapara nga lëndët janë në përputhshmëri të pjesshme me deskriptorët për zhvillim të kompetencave të programit studimor, respektivisht orientimi është në arritjen e studentëve vetëm në nivelin e njohjes me dukuritë që i ofrojnë lëndët në këtë program studimor.
- Vendosja kronologjike e lëndëve të programit studimor Ndërtimtari relativisht është në kontinuitet të zhvillimit dhe mbindërtimit të njohurive dhe shkathtësive të studentëve. Në përjashtim të dy lëndëve obligative që pjesërisht janë të vendosura në të njëjtin semestër ose i paraprijnë lëndëve njohurisë e të cilave duhet t'i mbindërtojnë, te lëndët zgjedhore nga gjithsej 27 lëndë , 9 janë pjesërisht të vendosura në të njëjtin semestër.
- Aktivitetet e planifikuara me të cilat ngarkohen studentët me qëllim të përfitimit të kompetencave përkatëse në të gjitha lëndët janë të planifikuara në përputhshmëri me numrin e kredive dhe shpërndarjen e orëve sipas numrit të kredive të lëndës përkatëse.
- Lëndët të cilat përbëjnë programin studimor Ndërtimtari përgjithësisht nxisin zhvillimin e shkathtësive të cilat janë të aplikueshme në tregun e punës. Megjithatë, me qëllim të avancimit të kompetencave por edhe rritjen e efikasitetit të kuadrove të reja në fushën e ndërtimtarisë, rreth 28% të lëndëve obligative dhe zgjedhore kanë nevojë për azhurnim pasi që nxisin pjesërisht shkathtësi si dhe 6% e lëndëve obligative dhe zgjedhore kanë nevojë për azhurnim pasi që aspak nuk nxisin shkathtësi të cilat janë të aplikueshme në treg të punës sipas kërkesave bashkëkohore.

4. VEPRIMTARIA MËSIMORE

Në pesë programe studimore të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara, atë të Ndërtimtarisë, Mekatronikës, Gjeodezisë dhe Gjeoinformatikës, studimet zgjasin 3 vjet, (gjashtë semestra) dhe studentët gjithsej akumulojnë 180 (ECTS) kredi kurse, studimet në programin studimor të Arkitekturës si dhe Inxhinierisë së Komunikacionit-Transportit zgjasin

4 vjet (tetë semestra) dhe studentët gjithsej akumulojnë 240 (ECTS) kredi. Numri i kredive të lëndëve në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara shtrihet prej 2 deri në 7 kredi, kurse tema e diplomës në programet studimore, Ndërtimtari, Mekatronikë dhe Komunikacion- Inxhinieri Transporti janë me 10 kredi, në programin studimor Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë tema e diplomës ka 5 kredi dhe në programin studimor Arkitekturë tema e diplomës ka 15 kredi. Programet studimore përbëhen nga lëndët obligative, zgjedhore dhe opcionale.

Në të gjitha programet studimore të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara realizohet mësimi teorik, por edhe ai praktik. Studentët realizojnë praktikën në institucione me të cilat është realizuar marrëveshje bashkëpunimi nga Universiteti, konkretisht në komuna, kompani vendore, firma të licencuara private ndërtimore, laboratorin e ndërtimtarisë që është në kuadër të FSHZ. Gjatë realizimit të praktikës studentët evidentojnë dhe përshkruajnë punën e tyre në ditarët praktikë.

Gjithashtu, në të gjitha programet studimore, në afatet e parapara të semestrave përkatës realizohen kolokuiumet për çdo lëndë. Në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara specifike janë lëndët projektuese. Ekuivalencë e kolokuiumeve në lëndët projektuese është realizimi i projekteve, i cili shkon në dy faza paraprake, respektivisht para dorëzimit final të projektit. Në kuadër të FSHZ-së është laboratorin i cili posedon pajisje për testimin dhe kontrollimin e agregatit, zhavorrit, betonit të freskët, çimentos dhe llaçit. Gjithashtu, pajisjet e laboratorit mundësojnë testim të konstruksioneve të betonit me metoda joerozive si dhe përcaktimin dhe matjen e thellësisë së armaturës.

4.1. Bashkëpunimi me kompanitë/institucionet në nivel të programeve studimore

Programi studimor *Arkitekturë* realizon bashkëpunim me 5 kompani, prej të cilave 2 janë të sektorit publik. Bashkëpunimi i tillë është shumë i rëndësishëm për këtë program studimor. Në të gjitha këto kompani studentët realizojnë pjesërisht punën praktike të paraparë me planprogram dhe 2 prej këtyre kompanive janë burim i mundshëm punësimi kurse 1 prej kompanive është pjesërisht burim i mundshëm punësimi për studentët. Në të gjitha këto kompani aktivitetet dominante të veprimtarisë së tyre realizohen pjesërisht nëpërmjet kompetencave të cilat janë të parapara të zhvillojë programin studimor të studentët.

Programi studimor *Mekatronikë* realizon bashkëpunim me 15 kompani, prej të cilave tre janë të sektorit publik. Bashkëpunimi me rreth 60% të këtyre kompanive është shumë i rëndësishëm për këtë program studimor, në veçanti është i rëndësishëm bashkëpunimi me hidrocentralet dhe termocentralet në vend. Në të gjitha kompanitë, studentët realizojnë punën praktike të paraparë me planprogram dhe paraqesin burim të mundshëm punësimi për ta. Në pjesën më të madhe të kompanive (rreth 86%) aktivitetet dominante të veprimtarisë së tyre realizohen nëpërmjet kompetencave të cilat janë të parapara të zhvillojë programi studimor te studentët. Kjo bën që kompanitë të jenë burim i mundshëm punësimi në të ardhmen për ta.

Programi studimor *Ndërtimtari* realizon bashkëpunim me 5 kompani prej të cilave 2 janë të sektorit publik. Bashkëpunimi me këto kompani është shumë i rëndësishëm për këtë program studimor. Në të gjitha kompanitë studentët realizojnë pjesërisht punën praktike të paraparë me planprogram dhe 2 prej tyre paraqesin burim potencial punësimi për ta ndërsa një kompani paraqet pjesërisht burimi potencial punësimi. Në të gjitha këto kompani aktivitetet dominante të veprimtarisë së tyre realizohen pjesërisht nëpërmjet kompetencave të cilat janë të parapara të zhvillojë programi studimor te studentët.

5. STRUKRURA E KUADRIT MËSIMOR-SHKENCOR

Në programet studimore të FSHZ-së, respektivisht, Arkitekturë, Ndërtimtari, Mekatronikë, Inxhinieria e Komunikacionit - Transportit dhe Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë gjithsej struktura e mësimdhënësve të rregullt është 16 profesorë dhe si drejtime specifike me lëndë të ndryshme në mësimdhënie janë të inkuadruar edhe 14 profesorë me kontratë. Këto programe edhe më tej vazhdojnë të perceptohen si profesione të gjinisë mashkullore. Më tej, nëse shohim proporcionin e mësimdhënësve me studentët, vërejmë se një profesori si dhe një bashkëpunëtori apo asistenti, i takon të punojë me 40 studentë në pjesën e ligjëratave kurse në pjesën e ushtrimeve ose ushtrimeve hulumtuese laboratorike me nga 10 studentë. Pasi vetë natyra e studimeve në programet studimore të FSHZ-së, respektivisht aktiviteti i studentëve dhe detyrat e projektet që priten të realizojnë e që njëkohësisht orientohen drejt profesionalizimit të mirëfilltë, kërkojnë që mësimdhënia të realizohet thuajse në mënyrë individuale duke ndjekur punën dhe detyrat e çdo studenti, në veçanti e ngarkon punën e

mësimdhënësve të rregullt. Prej këtu del edhe nevoja që të angazhohen me kontratë profesorë dhe bashkëpunëtorë asistentë. Numri i përgjithshëm i asistentëve të rregullt është tre (7) kurse numri i bashkëpunëtorëve- asistentë me kontratë është 34. Ky numër i stafit kontribuon që të realizohet në mënyrë të mirëfilltë procesi i mësimdhënies si për profesorët ashtu edhe për bashkëpunëtorët apo asistentët me nga rreth 10 studentë. Mësimdhënësit e angazhuar me kontratë në vepër që ligjërojnë në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara janë profesorë eminentë në fushat përkatëse, të përzgjedhur nga universitetet tjera siç janë Universiteti Prishtinës dhe ai i Tiranës.

Tabelat më poshtë japin një pasqyrë më të detajuar rreth titujve akademikë dhe moshës mesatare dhe gjinisë të stafit të angazhuar në këtë fakultet, të ndarë edhe sipas programeve studimore që funksionojnë në kuadër të FSHZ-së.

Kuadri mësimor - shkencor i FSHZ-së

Tabela 1. Struktura e kuadrit mësimor-shkencor për vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19

Mësimdhënës									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej
Ordinar	3	/	65	3	Ordinar	6	1	65	7
Inordinar	6	/	55	6	Inordinar	2	1	58	3
Docent	7	/	50	7	Docent	4	/	55	4
Gjithsej	16	/	56	16	Gjithsej	12	2	59	14

Tabela 2. Struktura e bashkëpunëtorëve për vitet akademike: 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19

Bashkëpunëtorë									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej
Asistent	/	2	28	7	Asistent	18	16	36	34
Asistent doktorant	4	1	40	/	Asistent i ri	/	/	/	/
Gjithsej	4	3	34	7	Gjithsej	18	16	36	34

Programi studimor Arkitekturë;

Fakulteti i Shkencave të Zbatuara-Факултет за применети науки-Faculty of Applied Sciences
 Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia
 www.unite.edu.mk – e-mail: apps@unite.edu.mk

Në programin studimor **Arkitekturë** procesin mësimor gjithsej e realizojnë 25 mësimdhënës. Prej tyre, 7 janë të rregullt, respektivisht 1 profesor inordinar, 2 profesorë docentë, 2 bashkëpunëtorë asistentë doktorantë dhe dy asistentë. Në programin studimor Arkitekturë numri i studentëve në 4 gjenerata është 200. Mësimdhënësit por edhe bashkëpunëtorët janë në përcjelljen e punës së një numri të madh të studentëve.

Në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19, në programin studimor Arkitekturë janë angazhuar 18 mësimdhënës me kontratë, ose konkretisht 3 profesorë dhe 15 bashkëpunëtorë. Kjo kontribuon që mësimdhënësit, respektivisht profesorët të përcjellin punën e 25 studentëve, kurse bashkëpunëtorët punën e 25 studentëve, gjë që kontribuon në mbarëvajtjen dhe ndjekjen e projekteve individuale të studentëve ashtu siç e kërkon Sistemi i Bolonjës por edhe natyra e programit studimor të Arkitekturës.

Tabela 3. Struktura e kuadrit mësimor-shkencor në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19 (Arkitekturë)

Profesorë									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej
Ordinar	/	/	/	/	Ordinar	/	1	65,55	1
Inordinar	2	/	46	2	Inordinar			55	
Docent	1	/	42,4	1	Docent	1	1	57	2
Asistent doktorant	2	/	42	2	Ligjërues (Dr.sc)	/	/	/	/
Gjithsej	5	/	42.4	5	Gjithsej	1	2	58	3

Tabela 4. Struktura e kuadrit mësimor-shkencor në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19 (Arkitekturë)

Bashkëpunëtorë									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej
Asistent	/	2	30	2	Asistent	/	/	/	/
Asistent i ri	///	/	/	/	Asistent i ri	3	12	38	15
	/	/	/	/		/	/	/	/

Gjithsej	/	2	30	2	Gjithsej	3	12	38	15
-----------------	---	---	----	---	-----------------	---	----	----	----

Programi studimor Ndërtimtari

Në programin studimor **Ndërtimtari** në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19, procesin mësimor e kanë realizuar gjithsej 12 mësimdhënës. Më konkretisht, prej tyre tetë (8) janë mësimdhënës të rregullt. Nga numri i përgjithshëm i studentëve dhe i gjithë stafit të angazhuar në programin studimor Ndërtimtari, arrihet që të përcillet puna e 12 gjegjësisht rreth 14 studentëve nga një profesor dhe nga një bashkëpunëtor asistent.

Tabela 5. Struktura e kuadrit mësimor-shkencor në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19(Ndërtimtari)

Profesorë									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej
Ordinar	1	/	60	1	Ordinar	/	/	/	/
Inordinar	2	/	65	2	Inrdinar	/	/	/	/
Docent	4	/	63	4	Docent	/	/	/	/
Asistent doktorant	/	1	45	/	Ligjërues (Dr.sc)	/	/	/	/
Gjithsej	7	1	58.2	8	Gjithsej	/	/	/	/

Tabela 6. Struktura e bashkëpunëtorëve për vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19 (Ndërtimtari)

Bashkëpunëtorë									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej
Asistent	/	/	/	/	Asistent	3	1	40	4
Asistent i ri	/	/	/	/	Asistent i ri	/	/	/	/
Gjithsej	/	/	/	/	Gjithsej	3	1	40	4

Programi studimor Mekatronikë

Në programin studimor **Mekatronikë** procesi mësimor realizohet nga 14 mësimdhënës, prej të cilëve 5 profesorë janë në marrëdhënie të rregullt pune, që kontribuojnë më shumë në ecurinë e studentëve rreth punës praktike, temave të diplomës, punëve laboratorike, si drejtim specifik kurse 5 profesorë dhe 4 asistentë janë me kontratë në vepër. Angazhimi i stafit të jashtëm në programin studimor të Mekatronikës kontribuon që të reduktohet numri i ndjekjes së studentëve në mësimdhënie dhe në pjesën praktike, punëve eksperimentale dhe laboratorike , pasi që si drejtim specifik ndonjëherë edhe kërkon demonstrime individuale për studentët.

Tabela 7. Struktura e kuadrit mësimor-shkencor në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19 (Mekatronikë)

Profesorë									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej
Ordinar	2	/	65	2	Ordinar	3	/	64	3
Inordinar	2	/	62	2	Inordinar	1	/	60	1
Docent	1	/	48	1	Docent	1	/	//	1
	/	/	/	/	Ligjërues (Dr.sc)	/	/	60	/
Gjithsej	5	/	58.3	5	Gjithsej	5	/	61.3	5

Tabela 8. Struktura e bashkëpunëtorëve në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19 (Mekatronikë)

Bashkëpunëtorë									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej
Asistent	/	/	/	/	Asistent	4	/	47	4
Asistent i ri	/	/	/	/	Asistent i ri	/	/	/	/
	/	/	/	/		/	/	/	/
Gjithsej	/	/	/	/	Gjithsej	4	/	45	4

Programi studimor Inxhinieri Komunikacioni - Transporti

Në programin studimor **Inxhinieri Komunikacioni - Transporti** në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19, procesin mësimor e kanë realizuar gjithsej 14 mësimdhënës. Më konkretisht 5 prej tyre janë profesorë, 2 ligjërues, 1 i rregullt, kurse 6 me kontratë si dhe 7 bashkëpunëtorë (asistentë) me kontratë në vepër.

Tabela 9. Struktura e kuadrit mësimor-shkencor në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19 (Inxhinieri Komunikacioni – Transporti)

Profesorë									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej
Ordinar	/	/	/	/	Ordinar	/	/	/	/
Inordinar	/	/	/	/	Inordinar	2	/	46	2
Docent	1	/	50	1	Docent	2	/	50	2
	/	/	/	/	Ligjërues (Dr.sc)	2	/	58	/
Gjithsej	1	/	50	1	Gjithsej	6	/	51	6

Tabela 10. Struktura e bashkëpunëtorëve në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19 (Inxhinieri Komunikacioni – Transporti)

Bashkëpunëtorë									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali	Kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali
Asistent	/	/	/	/	Asistent	4	1	38	5
Asistent i ri	/	/	/	/	Asistent i ri	2	/	52	2
	/	/	/	/		/	/	/	/
Gjithsej	/	/	/	/	Gjithsej	6	1	45	7

Programi studimor Gjeodezia dhe Gjeoinformatika;

Në programin studimor **Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë** në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19, procesin mësimor e kanë realizuar gjithsej 10 mësimdhënës. Më

konkretisht 1 asistent doktorant që është kuadër i rregullt dhe 4 profesorë me kontratë si dhe 5 bashkëpunëtorë (asistentë) me kontratë.

Tabela 11. Struktura e kuadrit mësimor-shkencor në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19 (Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë)

Profesorë									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej
Ordinar	/	/	/	/	Ordinar	2	/	62	2
Inordinar	/	/	/	/	Inordinar	2	/	62	2
Docent	/	/	/	/	Docent	/	/	/	/
Asistent doktorant	1	/	30	1	Ligjërues (Dr.sc)	/	/	/	/
Gjithsej	/	/	30	1	Gjithsej	4	/	62	4

Tabela 12. Struktura e bashkëpunëtorëve në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19 (Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë)

Bashkëpunëtorë									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej	Kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej
Asistent	/	/	/	/	Asistent	2	1	45	3
Asistent i ri	/	/	/	/	Asistent i ri	2	/	42	2
	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Gjithsej	/	/	/	/	Gjithsej	4	1	42.5	5

6. STRUKTURA E STUDENTËVE

6.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike

Në vazhdim në mënyrë tabelare dhe me diagrame kemi paraqitur numrin e përgjithshëm të studentëve në kuadër të FSHZ-së, si dhe numrin e studentëve në çdo program studimor për vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19.

Tabela 13. Struktura e studentëve në FSHZ në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19

FSHZ	2016/17			2017/18			2018/19		
	S	M	F	S	M	F	S	M	F
Programi studimor									
ARKITEKTURË	245	145	100	204	115	89	255	145	110
NDËRTIMTARI	59	59	0	36	30	6	50	38	12
MEKATRONIKË	28	26	2	40	40	0	17	17	0
GJEODEZI DHE GJEONFORMATIKË	58	48	10	56	46	10	37	30	7
KOMUNIKACION INXHINIERI – TRANSPORTI	31	21	7	32	27	5	35	29	6
Gjithsej	424	305	119	368	258	110	404	269	135
Të çregjistruar	16	6	0	27	23	4	10	8	2




Figura 2. Numri i përgjithshëm i studentëve në FSHZ




Figura 3. Numri i studentëve sipas gjinisë në FSHZ

Programi studimor Arkitekturë

Tabela 14. Struktura e studentëve në Arkitekturë në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19

Arkitekturë	2016-2017			2017-2018			2018-2019		
	Studentë	M	F	Studentë	M	F	Studentë	M	F
I	70	44	26	66	40	26	50	30	20
II	67	45	22	46	25	21	40	20	20
III	62	36	26	42	17	25	116	70	46
IV	46	20	26	50	33	17	49	25	24
Total	245	145	100	204	115	89	255	145	110
Te çregjistruar	16	6	10	23	19	4	10	8	2




Figura 4. Numri i studentëve në programin studimor Arkitekturë




Figura 5. Numri i studentëve sipas gjinisë në programin studimor Arkitekturë

Programi studimor Ndërtimtari

Tabela 15. Struktura e studentëve në Ndërtimtari në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19

Ndërtimtari	2016-2017			2017-2018			2018-2019		
	Studentë	M	F	Studentë	M	F	Studentë	M	F
I	23	23		12	10	2	18	14	4
II	18	18		12	10	2	16	12	4
III	18	18		12	10	2	16	12	4
IV									
Total	59	59	0	36	30	6	50	38	12
Te çregjistruar									




Figura 6. Numri i studentëve në programin studimor **Ndërtimtari**




Figura 7. Numri i studentëve sipas gjinisë në programin studimor **Ndërtimtari**

Programi studimor Mekatronikë

Tabela16. Struktura e studentëve në **Mekatronikë** në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19

Mekatronikë	2016-2017			2017-2018			2018-2019		
	Studentë	M	F	Studentë	M	F	Studentë	M	F
I	16	15	1	23	23	0	11	11	0
II	7	6	1	10	10	0	6	6	0
III	5	5	0	7	7	0	0	0	0
IV									
Total	28	26	2	40	40	0	17	17	0
Te çregjistruar				2	2	0	0	0	0




Figura 8. Numri i studentëve në programin studimor **Mekatronikë**




Figura 9. Numri i studentëve sipas gjinisë në programin studimor **Mekatronikë**

Programi studimor Inxhinieri Komunikacioni –Transporti

Tabela 17. Struktura e studentëve në Inxhinierinë e Komunikacionit – Transportit në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19

Inxhinieri Komunikacioni dhe Transporti	2016-2017			2017-2018			2018-2019		
	Studentë	M	F	Studentë	M	F	Studentë	M	F
I	14	8	3	11	11	0	13	12	1
II	17	13	4	8	7	1	7	7	0
III				13	9	4	5	4	1
IV							10	6	4
Total	31	21	7	32	27	5	35	29	6
Te çregjistruar				1	1	0	0	0	0




Figura 10. Numri i studentëve në programin studimor Inxhinieri komunikacion – transporti




Figura 11. Numri i studentëve sipas gjinisë në programin studimor Inxhinieri komunikacion – transporti

Programi studimor Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë

Tabela 18. Struktura e studentëve në Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19

Gjeodezi dhe gjeoinformatikë	2016-2017			2017-2018			2018-2019		
	Studentë	M	F	Studentë	M	F	Studentë	M	F
I	35	28	7	11	9	2	0	0	0
II	23	20	3	24	19	5	7	5	2
III				21	18	3	30	25	5
IV									
Total	58	48	10	56	46	10	37	30	7
Te çregjistruar	0	0	0	1	1	0	0	0	0




Figura 12. Numri i studentëve në programin studimor **Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë**




Figura 13. Numri i studentëve sipas gjinisë në programin studimor **Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë**

6.2. Struktura e studentëve në studimet master

Në studimet e nivelit master gjatë kësaj periudhe që i nënshtrohet procesit të evaluimit, procesi mësimor është zhvilluar vetëm në dy programe studimore, edhe atë; *Arkitekturë* dhe *Mekatronikë*. Në vazhdim në mënyrë tabelare kemi paraqitur numrin e studentëve nëpër vite.

Tabela 19. Struktura e studentëve në **FSHZ** në vitet akademike 2016/17; 2017/18 dhe 2018/19

FSHZ	2016/17			2017/18			2018/19		
	S	M	F	S	M	F	S	M	F
Programi studimor									
ARKITEKTURË	28	18	10	0	0	0	10	5	5
MEKATRONIKË	4	4	0	8	8	0	4	4	2
Gjithsej	32	22	10	8	8	0	14	9	7





Figura 14 Numri i studentëve në programin studimor **Arkitekturë**




Figura 16. Numri i studentëve në programin studimor **Mekatronikë**

Figura 10. Numri i studentëve sipas gjinisë në programin studimor **Arkitekturë**




Figura 17. Numri i studentëve sipas gjinisë në programin studimor **Mekatronikë**

Fakulteti i Shkencave të Zbatuara para studentëve të tij potencial prezantohet në kuadër të promovimit të përgjithshëm të Universitetit të Tetovës. Ky proces realizohet gjatë muajit prill dhe në kuadër të një komisioni prej disa anëtarëve realizohet vizitë nëpër shkollat e mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Gjatë këtyre vizitave prezantohen fakultetet, programet studimore, karakteristikat e tyre, si dhe kushtet tjera që i ofrojnë programet studimore për mbarëvajtje të procesit mësimor-shkencor në të gjitha fakultetet përkatëse në kuadër të Universitetit të Tetovës. Përpos tjerash, promovimi i Fakultetit të Shkencave të Zbatuara realizohet edhe në kuadër të ditëve të hapura që mbahen në hapësirat e Universitetit, me ç'rast ofrohen materiale të ndryshme promovuese, por njëkohësisht u ofrohet mundësi studentëve potencialë për së afërmi të përjetojnë hapësirat e fakultetit.

7. ANKETIMI I STUDENTËVE

7.1. Anketim i studentëve për realizimin e orës mësimore në kuadër të programeve studimore

Anketimi i studentëve gjatë vitit 2016 është realizuar nëpërmjet vlerësimit të orës mësimore nga 346 studentë. Rreth 81% e studentëve vlerësojnë se ligjëratat fillojnë saktë sipas orarit, kurse rreth 67% se ligjëratat mbarojnë në kohën e paraparë sipas orarit të

shpallur. Për realizim të orëve gjatë ligjëratave në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara, në të gjitha programet studimore pa përjashtim, dominues është përdorimi i power point prezantimeve. Për të njëjtën se përdoret gjatë ligjëratave, deklarojnë 45% e studentëve, kurse 21% shtojnë se përdoret shkrimi në dërrasë.

Realizimi i ligjëratave

Studentët e kanë vlerësuar realizimin e orës në lëndë të caktuara nëpërmjet shtatë pyetjeve. Në kuadër të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara vlerësimi më pozitiv ka qenë për sigurinë, bindshmërinë dhe qartësinë e mësimdhënësve gjatë ligjërimit (M= 4.54; M=4.38; M=4.34). Që të tre karakteristikat e mësimdhënësve janë vlerësuar si dominonte pozitive në të gjitha programet studimore të Fakultetit.

Tabela 20. Mesataret e indikatorëve të realizimit të ligjëratave

FSHZ	Tema në përputhshmëri me ligjëratat	Ligjërata të qarta	Ligjërues i sigurt	Ligjërues bindës
	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)
	4.09 (346)	4.34 (346)	4.54 (346)	4.38 (346)

Përmbajtja e ligjërimit/prezantimit është vlerësuar nëpërmjet 14 pohimeve në të cilat janë përgjigjur me pesë opsione të mundshme, prej aspak nuk pajtohem (1) deri plotësisht pajtohem (5). Studentët kanë deklaruar se materiali i prezantuar gjatë ligjërimit ka qenë në përputhshmëri me temën e prezantuar në fillim të orës (M=3.83), kanë pyetur studentët për paqartësi (M=4.90) dhe se studentët e kanë pasur të qartë në çka duhet të fokusohen për të përgatitur temën e ligjëruar gjatë orës për të cilën është realizuar evaluimi (M=4.12). Studentët gjithashtu për orët për të cilat është realizuar evaluimi thonë se nuk është bërë lidhshmëria e përmbajtjeve të prezantuara me temat paraprake (M=3.77), tabela 21.

Tabela 21. Mesataret e indikatorëve të përmbajtjes së ligjëratave

FSHZ	Orientim në pikat kyçe të temës	Lidhshmëri me tema paraprake	Ilustrim me shembuj i përmbajtjes	Lidhshmëri për përdorim të njohurive në praktikë	Motivon për pjesëmarrje aktive në ligjëratë
	Mesatarja	Mesatarja	Mesatarja	Mesatarja	Mesatarja
	(N)	(N)	(N)	(N)	(N)
	3.83 (346)	3.77 (346)	4.18 (346)	3.67 (346)	3.89 (346)

Menaxhimi i orës është vlerësuar nëpërmjet shtatë pohimeve. Përgjigjet e mundshme në të gjitha pohimet kanë lëvizur prej opsionit aspak nuk pajtohem (1) deri plotësisht pajtohem (5). Studentët në nivel të fakultetit japin vlerësime pozitive në dukuritë e menaxhimit të orës megjithatë me mjaft hapësirë për t'u avancuar. Studentët kanë veçuar se nuk ka pasur zhurmë gjatë ligjëratës (M=1.45), mësimdhënësit kanë qenë të paanshëm dhe kanë lënë hapësirë për diskutim për të gjithë studentët (M=3.23) dhe se kanë stimuluar studentët për pjesëmarrje aktive në ligjëratë (M=2.84).

Interaksionin joverbal të mësimdhënësve, studentët e kanë vlerësuar nëpërmjet dhjetë pohimeve, gjithashtu me pesë opsione të mundshme për përgjigje edhe atë prej aspak nuk pajtohem (1) deri plotësisht pajtohem (5). Në tërësi studentët vlerësojnë pozitivisht interaksionin e mësimdhënësve ndaj tyre gjatë realizimit të ligjëratës. Kontakti joverbal me të gjithë studentët si vëzhgim i balancuar ndaj gjithë studentëve (M=4.11), si dhe studentët kanë deklaruar se mësimdhënësit ua kanë mbajtur vëmendjen e fokusuar në temë (M=3.96) kanë qenë dukuritë e veçuara më pozitive në kuadër të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara (Tabela 22).

Tabela 22. Mesataret e indikatorëve të përmbajtjes së menaxhimit të orës nga mësimdhënësi

FSHZ	Dëgjoi në mënyrë aktive komentet e	Stimuloi për pjesëmarrje aktive në	Ishte i paanshëm gjatë diskutimit të	Mbajti koncentrimin e studentëve	Vëzhgim i balancuar ndaj gjithë studentëve	Të kënaqur nga realizimi i
-------------	-------------------------------------------	-------------------------------------------	---------------------------------------------	-----------------------------------------	---------------------------------------------------	-----------------------------------

	studentëve	ligjëratë	studentëve			orës
	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)
	3.07 (346)	2.84 (346)	3.23(346)	4.07 (346)	4.11 (346)	4.09 (346)

8. VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE PJESËMARRJA NË PROJEKTE

Mësimdhënësit e Fakultetit të Shkencave të Zbatuara, përveç se realizojnë procesin mësimor janë edhe pjesëmarrës aktiv në numër të konsiderueshëm të aktiviteteve shkencore në vend, rajon dhe më gjerë. Gjatë vitit akademik 2016/17, 2017/18, 2018/19 stafi akademik ka marrë pjesë me disa punime në simpoziume të ndryshme. Disa prej konferencave në të cilat ka marrë pjesë stafi i Fakultetit të Shkencave të Zbatuara:

- Journal of Applied Sciences-SUT JAS-SUT, Vol.2,No.3-4/2016UDC 72, 62,69 ISSN 1857-9930 (Print), ISSN2671-3047 (Online);
- Journal of Applied Sciences-SUT JAS-SUT, Vol.3,No.5-6/2017UDC 72, 62,69 ISSN 1857-9930 (Print), ISSN2671-3047 (Online);
- Journal of Applied Sciences-SUT JAS-SUT, Vol.4,No.7-8/2018UDC 72, 62,69 ISSN 1857-9930 (Print), ISSN2671-3047 (Online);
- Journal of Applied Sciences-SUT JAS-SUT, Vol.5,No.9-10/2019UDC 72, 62,69 ISSN 1857-9930 (Print), ISSN2671-3047 (Online);
- Journal of Applied Sciences-SUT JAS-SUT, Vol.6,No.11-12/2020UDC 72, 62,69 ISSN 1857-9930 (Print), ISSN2671-3047 (Online);
- 9th Ubt Annual International Conference OnCivil Engineering, Infrastructure And Environment Date: October 30 - 31, 2020 Prishtine;
- UBT International Conference 2017, October 27-29, 2017, Durrës- Albania ISBN 978-9951-437-54-7;

- First Western Balkan Conference Gis, Mine Surveying, Geodesy And Geomatics Tirana, Albania 3-4 October 2018 – Isbn 978-9928-07-599-4;
- International Conference of Applied Sciences - ICAS2017, Abstract book 2017, Tetova (MACEDONIA);
- Architectural style transformation in Tetova between 1914-1990, 3ICAUD, Epoka University, Tirana, 2019. (Proceedings);
- IC-ASP, 8th Annual International Conference on Business, Technology and Innovation, Prishtina, Kosova, 2019;
- Expert international counseling at the Bureau of Judicial Expertise, 6-7 May 2016, Ohrid, Macedonia;
- Expert international counseling at the Bureau of Judicial Expertise, 12-13 May 2017, Struga, Macedonia;
- Expert international counseling at the Bureau of Judicial Expertise, 2-3 May 2019, Struga, Macedonia;
- 3rd International Forum on Architecture and Urbanism, Book of Abstract, IFAU'19, Tiranë, Shqipëri, 2019;
- First Macedonia Road Congress, Shkup, 2019. (Proceedings);
- MASE ДГКМ, Macedonian Association of Structural Engineers, Ohrid, North Macedonia, 2 – 5 October 2019 Охрид, Република Северна Македонија;
- Reading The Syntax Of Space, You Can Understand The Structure Of The Massive Structural System Of The Gorna Reka House 2nd International Cogress On Ronds-Tirana 24-25 September 2015, 9-789928-202017.

9. HAPËSIRAT DHE RESURSET MATERIALE

Procesi mësimor në kuadër të FSHZ-së realizohet në një objekt. Me qëllim të realizimit të procesit mësimor për nevojat e programeve studimore të FSHZ-së përdoren 13 klasa, 10 zyra për mësimdhënësit dhe 2 për administratën (tabela 23). Gati shumica e klasave janë të pajisura me video projektorë si dhe zyrat e stafit mësimor me kompjuterë dhe printerë dhe të gjitha të rinovuara në vitin 2020.

Për plotësimin e nevojave praktike, në dispozicion është një laborator si dhe 1 hapësirë e përbashkët për të gjitha programet, hapësira me kompjuterë. Nga viti akademik

Fakulteti i Shkencave të Zbatuara-Факултет за применети науки-Faculty of Applied Sciences
 Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia
 www.unite.edu.mk – e-mail: apps@unite.edu.mk

2016/17 deri 2018/19, në FSHZ për nevojat e stafit dhe administratës kanë qenë në dispozicion dy hapësira për punët administrative dhe sekretarin e fakultetit, të pajisura me 8 kompjuterë, 3 printerë dhe 1 skaner. Për nevojat e studentëve të FSHZ-së të programeve studimore Arkitekturë dhe Ndërtimtari shërben edhe laboratorin për testimin dhe kontrollimin e materialeve ndërtimore në kuadër të UT-së.

Laboratori posedon pajisje për testimin dhe kontrollimin e agregatit, zhavorrit, betonit të freskët, çimentos dhe llaçit. Gjithashtu pajisjet e laboratorit mundësojnë testim të konstruksioneve të betonit me metoda joerozive si dhe përcaktimin dhe matjen e thellësisë së armaturës. Më poshtë janë të shënuara dhe të ndara në tabela pajisjet dhe hapësirat për FSHZ -në dhe programet studimore nga tabela 24 deri në 28.

Tabela 23. Hapësira punuese dhe pajisje në FSHZ nga viti 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19

	Hapësira dhe pajisje të FSHZ-së	Numri	m ²	Numri i ulëseve
1	Kabinete mësimore klasa	13	540	462
2	Laborator	1	393	85
3	Amfiteatër	1	1	80
4	Zyra të stafit mësimor	10	193	18
5	Zyra administrative	2	51	11
6	Hapësira me kompjuterë	1	42	24
7	Laborator eksperimentues	/	/	/
8	Bibliotekë	/	/	/
Gjithsej		27	1219	680
	Pajisje të kuadrit të FSHZ			Numri i pajisjeve
1	Kompjuterë për stafin mësimor	9	/	9
2	Printerë	6	/	6
3	Video projektorë	6	/	6
4	Kompjuterë për studentë	34	/	34
Gjithsej		49	/	49
	Pajisje të administratës			
1	Kompjuterë	8	/	8
2	Printerë	3	/	3
3	Skaner	1	/	1

Gjithsej	12	/	12
-----------------	----	---	----

Tabela 24. Hapësira punuese dhe pajisje në programin studimor **Arkitekturë** në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19

	Hapësira dhe pajisje	Numri	m²	Numri i ulëseve
1	Kabinete mësimore klasa	3	240	140
2	Laborator	1	393	85
3	Amfiteatër	1	120	80
4	Zyra të stafit mësimor	3	74	6
5	Hapësira me kompjuterë	1 përbashkët	42	24
Gjithsej		8	749	255
	Pajisje	Numri		Numri i pajisjeve
6	Kompjuterë të stafit mësimor	3	/	3
7	Printer	2	/	2
8	Video projektorë	2	/	2
Gjithsej		7	/	7

Tabela 25. Hapësira punuese dhe pajisje në programin studimor **Ndërtimtari** në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19

	Hapësira dhe pajisje	Numri	m²	Numri i ulëseve
1	Kabinete mësimore klasa	2	80	90
2	Laborator	1	393	85
3	Amfiteatër	/	/	/
4	Zyra të stafit mësimor	2	43	4
5	Hapësira me kompjuterë	1 përbashkët	42	24
Gjithsej		6	558	203
	Pajisje	Numri		Numri i pajisjeve
6	Kompjuterë të stafit mësimor	2	/	2
7	Printer	2	/	2
8	Video projektorë	2	/	2
Gjithsej		6	/	6

Tabela 26. Hapësira punuese dhe pajisje në programin studimor **Mekatronikë** në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19

	Hapësira dhe pajisje	Numri	m²	Numri i ulëseve
1	Kabinete mësimore klasa	3	110	102
2	Laborator	/	/	/
3	Amfiteatër	/	/	/
4	Zyra të stafit mësimor	2	50	4
5	Hapësira me kompjuterë	Një hapësirë e përbashkët	42	24
Gjithsej		6	202	130
	Pajisje	Numri		Numri i pajisjeve
6	Kompjuterë të stafit mësimor	2	/	2
7	Printer	2	/	2
8	Video projektorë	2	/	2
Gjithsej		6	/	6

Tabela 27. Hapësira punuese dhe pajisje në programin studimor **Inxhinieri Komunikacioni – Transporti** nga viti 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19

	Hapësira	Numri	m²	Numri i ulëseve
1	Kabinete mësimore klasa	2	70	70
2	Laborator	/	/	/
3	Amfiteatër	/	/	/
4	Zyra të stafit mësimor	2	27	2
5	Hapësira me kompjuterë	1 përbashkët	42.4	24
Gjithsej		4	128.4	96
	Pajisje	Numri		Numri i pajisjeve
6	Kompjuterë të stafit mësimor	1	/	1
7	Printer	1	/	1
8	Video projektorë	1	/	1
Gjithsej		3	/	3

Tabela 28. Hapësira punuese dhe pajisje në programin studimor **Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë** nga viti 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19

	Hapësira	Numri	m ²	Numri i ulëseve
1	Kabinete mësimore klasa	2	60	60
2	Laborator	/	/	/
3	Amfiteatër	/	/	/
4	Zyra të stafit mësimor	1	14	2
5	Hapësira me kompjuterë	1 përbashkët	42.4	24
Gjithsej		4	116	86
	Pajisje	Numri		Numri i pajisjeve
6	Kompjuterë të stafit mësimor	1	/	1
7	Printer	1	/	1
8	Video projektorë	1	/	1
Gjithsej		3	/	3

10. SWOT ANALIZA

Në tabelën më poshtë në kuadër të SWOT analizës, kemi paraqitur „anët e forta“ dhe „anët e dobëta“ të ambientit të brendshëm të Fakultetit, të cilat varen nga Fakulteti dhe Universiteti, në të cilat mund të ndikohet dhe veprohet nga vetë institucioni si dhe faktorët e jashtëm që ndikojnë në punën dhe veprimtarinë e Fakultetit në të cilat nuk mund të kemi ndikim por duke i ditur dhe evidentuar ne mund të ndikojmë në veprimin tonë të mëtejshëm.

Tabela 29. Analiza SWOT në kuadër të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara

	Pozitive	Negative
	(S) Anët e forta	(W) Anët e dobëta
Të brendshme	1. Institucion i parë arsimor me përvojë disavjeçare në gjuhën shqipe që ofron drejtime tekniko-inxhinierike në gjuhën shqipe në	1. Investime jo të mjaftueshme në infrastrukturën e fakultetit; mjete, pajisje, makina dhe laborator për drejtimet tjera si të Mekatronikës,

	<p>RMV;</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. Stafi akademik shkencor e profesional me përvojë; 3. Është në bashkëpunim të vazhdueshëm me ndërmarrje, kompani dhe institucione të ndryshme shtetërore dhe private e cila paraqet një mundësi për punësim; 4. Pozita gjeografike, kushtet që ofrohen për jetë studentore, akomodim dhe studim; 5. Hapja e drejtimeve të reja duke marrë parasysh nevojën dhe kërkesën e tregut të punës; 6. Punësimi i kuadrove inxhinierike profesionale në vende të ndryshme, institucione, kompani, etj.; 7. Bashkëpunimi i Universitetit me universitetet në vend, rajon dhe botë si dhe mundësia që përmes programit Erasmus studentët të ndjekin disa semestra jashtë. 8. Stimulimi, dhënia e bursave për studentët ekselencë për vazhdim të studimeve në master dhe mundësinë e inkuadrimit të tyre në procesin mësimor si demonstratorë, dhe më pas edhe si asistentë bashkëpunëtorë të rregullt; 9. Organizimi i Konferencave Shkencore Ndërkombëtare si dhe publikimi i revistës Journal of Applied Sciences-SUT JAS-SUT, poashtu dhe të botojmë deri më tani 	<p>Komunikacionit dhe Gjeoinformatikës;</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. Mungesë e kuadrit akademik të rregullt profesional i cili do të plotësonte nevojat e procesit mësimor; 3. Largimi/shkuarja e kuadrit akademik shkencor si rezultat i procesit natyror, pensionit apo fatkeqësive tjera natyrore; 4. Nevoja për hapësira të reja dhe pajisje për punë dhe veprim ku studentët do të mund të shfaqnin aftësitë, talentin dhe kreativitetin e tyre shkencor, hulumtues dhe novator; 5. Nevoja për komunikim më të rregullt të studentëve me profesorët që vijnë nga Fakultetet tjera të UT-së si p.sh. FSHMN, Fakultetit Filozofik etj. ; 6. Studimet trevjeçare në Bacheor në disa drejtime pengojnë kuadrin për avancime dhe marrje licencash; 7. Pagesa e lartë e semestrit në studime Master.
--	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

	(2019), Vol.5, No.9-10/2019, UDC 72, 62,69 ISSN 1857-9930 (Print), ISSN 2671-3047 (Online), e cila tani më është revistë e pranuar, indeksuar në google – scholar; 10. Laboratori modern për Testim dhe Kontrollin e materialeve.	
	(O) Mundësitë	(T) Rreziqet / Kërcënimet
Të Jashtme	<ol style="list-style-type: none"> Hapja e ndërmarrjeve të reja prodhuese; Ofrimi i krijimit të kuadrove/profileve të reja për nevojat e tregut; Fakulteti, stafi dhe studentët shfrytëzojnë mundësitë që u ofrohen për bashkëpunim nga ana e institucioneve shtetërore dhe kompanive private dhe njëherit edhe nga vetë fakulteti ofrohen mundësi bashkëpunimi. 	<ol style="list-style-type: none"> Situata ekonomike e përkeqësuar në vend; Mospasja e perspektivës së të rinjve për të jetuar në vend; Shtrirja dhe hapja e shumë universiteteve me profile të njëjta në shumë qytete të vendit si dhe tërheqja e studentëve me çdo kusht duke bërë një konkurrencë jolojale (negative) për vetë procesin mësimor dhe përgatitjen profesionale; Punësimi dhe inkuadrimi i kuadrove duke mos i respektuar kriteret dhe aftësitë profesionale; Mosmbrojtja ligjore nga ana e shtetit e kuadrit inxhinierik profesional në vendet e punës në ndërmarrjet private dhe pagesa e ulët ose thjesht kuadrot merren vetëm për të plotësuar nevojën ligjore.

11.KONKLUDIMI

Fakulteti i Shkencave të Zbatuara zhvillon veprimtarinë e vetë shkencore në kuadër të Universitetit të Tetovës në disa programe studimore siç janë: Arkitekturë, Ndërtimtari, Mekatronikë, Inxhinieri Komunikacioni – Transporti dhe Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë. Gjatë periudhës 2016/17 -2018/19 nuk ka funksionuar programi studimor Inxhinieri Ekonomike i cili ka qenë në pauzë.

Programet studimore në kuadër të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara funksionojnë sipas principeve të Deklaratës së Bolonjës dhe në pajtim me Ligjin për arsim të lartë dhe Statutin e UT-së.

Veprimtaria akademike-shkencore realizohet nga kuadër kompetent, që në vazhdimësi realizojnë publikime shkencore në revista si dhe marrin pjesë në konferenca vendore e ndërkombëtare dhe përmes aktiviteteve të tilla synohet realizimi i procesit arsimor dhe punës praktike në drejtim të rritjes së kualitetit, vlerësimit të vazhdueshëm të procesit arsimor, realizimit të planeve mësimore dhe arritjes së qëllimeve në kuadër të programeve studimore.

Gjatë gjithë kësaj periudhe trevjeçare procesi mësimor është zhvilluar normalisht nga stafi akademik i Fakultetit, stafi nga fakultetet tjera në kuadër të UT-së dhe për nevoja profesionale në lëmi të ndryshme të programeve studimore janë angazhuar profesorë edhe nga Universitetet tjera. Përveç procesit mësimor në studimet e ciklit të parë, në disa drejtime procesi mësimor është realizuar edhe në ciklin e dytë. Studentët kryesisht janë nga vendi, por gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe studentë nga vende tjera, kryesisht Kosova dhe Shqipëria.

Numri i studentëve duke pasur parasysh krahasimin e tyre me disa vite më parë tregon një zvogëlim në të gjitha drejtimet. Kjo dukuri nuk ka të bëjë vetëm me Fakultetin e Shkencave të Zbatuara, por me të gjitha drejtimet dhe gjithë universitetet tjera në vend. Kjo është si rezultat i situatës politiko-ekonomike në vend ku pjesa më e madhe e rinisë për arsye të ndryshme ekonomike, duke mos parë perspektivë janë duke migruar në vendet perëndimore.

Me qëllim të rritjes së informimit dhe hulumtimeve të studentëve për të gjitha çështjet e lartpërmendura sugjerohet që Fakulteti i Shkencave të Zbatuara të ketë në dispozicion edhe disa pajisje dhe hapësira që do ndihmojnë edhe më shumë në avancimin e procesit mësimor.

Fakulteti i Shkencave të Zbatuara-Факултет за применети науки-Faculty of Applied Sciences
Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia
www.unite.edu.mk – e-mail: apps@unite.edu.mk

Prej tyre mund të veçohen:

1. Studio me shtafellaj për lëndët e artit në Arkitekturë dhe kabinet me tavolina speciale për arkitektë për lëndët e projektimit, studio për përgatitje të maketave dhe magazinë për ruajtjen e punimeve;
2. Laborator për hulumtime të mekatronikës, elektroteknikës në programin studimor Mekatronikë;
3. Pajisje të ndryshme për programet studimore Ndërtimtari, Inxhinierin e Komunikacionit-Transportit dhe në programin Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë;
4. Bibliotekë për FSHZ-në;
5. Web ose classroom për çdo program studimor për shpallje të rezultateve informimeve të studentëve etj.;
6. Ekране elektronike dhe pajisje tjera për ligjërata;
7. Fotokopje për FSHZ-në.

Për realizimin dhe zhvillimin e mëtejshëm normal të punës së FSHZ-së, në bazë të analizës SWOT (anëve të forta,të dobëta, mundësive dhe rreziqeve), mund të japim disa propozime, rekomandime nga të cilat do të ndërmerren masa të mëtejshme, siç janë:

- Të bëhen investime në ndërtimin e laboratorëve për programe të caktuara për realizimin e pjesës praktike profesionale;
- Të krijohen hapësira pune për vendosje të mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për punë ku studentët do të mund të veprojnë dhe punojnë për realizimin e qëllimeve, detyrave dhe aktiviteteve të tyre;
- Të pranohen kuadro të reja profesionale, duke filluar nga stafi akademik, profesorë dhe asistentë të cilët do të jenë një garancë për vazhdimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të procesit mësimor;
- Të stimulohen stafi akademik për punën shkencore hulumtuese dhe punën e tyre me studentë;
- Stimulimi dhe dhënia e bursave për studentët ekselencë, inkuadrimi i tyre në procesin mësimor si demonstratorë;

- Kalimi i disa kuadrove nga FSHMN, Filologjik, që mbajnë mësim – lëndë si matematika, fizika dhe gjuhë të huaj angleze ose gjermane, si staf i rregullt në FSHZ. Në këtë mënyrë ata do të jenë më afër studentëve dhe do të merren më profesionalisht sipas nevojës së programeve studimore.
- Kalimi nga programet trevjeçare në ato katërvjeçare, për arsye se kjo nuk u mundëson studentëve marrjen e licencave të nevojshme.

Komisioni për vetevaluim i FSHZ-së:

1. Prof. Dr. Asan Idrizi, kryetar
2. Prof. Mr. Burim Ukiçi, anëtar
3. Doc. Dr. Nuran Saliu, anëtar
4. Doc. Dr. Shazim Memeti, anëtar
5. Doc. Dr. Idaver Huseini, anëtar
6. Diellza Saiti, anëtar
7. Alma Januzi, anëtar